



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:080178
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05500670

Ac.nr.3809/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Nehat Idrizi dhe Dardan Kadolli, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit A.B, nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson A.L., avokat në Prishtinë, sipas autorizimit, kundër të paditurës: Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, Magjistralja Prishtinë - Fushë Kosovë, rr. “Lidhja e Pejës” pn., të cilën e përfaqëson përfaqësuesja e autorizuar M.K., sipas autorizimit, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarit të paditësit dhe ankesës së përfaqësueses së autorizuar të paditurës të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.437/17 datë 18.02.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.03.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pabazuar ankesa e paditësit A.B. nga Ferizaj dhe ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.437/17 i datës 18.02.2020, në pikën I, të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadsisë për kompensimin e dëmit jomaterial në emër të dhimbjeve fizike, frikës së përjetuar, shëmtimit trupor dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe për kompensimin e dëmit material dhe atë: për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj, ushqimin e përforcuar dhe për zvogëlimin e aftësisë punuese - fitimin e humbur, kamatën dhe për shpenzimet e procedurës, në pikën II, të dispozitivit, në pjesën refuzuese të kërkesëpadsisë së paditësit për kompensimin e dëmit jomaterial dhe për shpenzimet e procedurës, VËRTETOHET.

II. APROVOHET ankesa e paditësit Avni Beqiri nga Ferizaj, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.437/17 i datës 18.02.2020, në pikën I të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadsisë për kompensimin e dëmit material për shpenzimet e mjekimit dhe gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, që paditësit A.B. nga Ferizaj në emër të kompensimit

të dëmit material të pësuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 18.04.2017, t'i paguaj shumën prej 6,500.95€, me kamatë prej 8%, e cila llogaritet nga data 18.02.2020 e deri në pagesën përfundimtare të detyrimit.

III. Mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën I, në pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material për rehabilitimin klimaterik.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.437/17, të datës 18.02.2020, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të: Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.B nga Ferizaj dhe Detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë që në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, të shkaktuar si pasojë e aksidentit të datës 18.04.2017 t'ia paguaj paditësit shumat në vijim: për dhimbje fizike shumën prej 5,000.00 Euro, për frikë shumën prej 4,000.00 Euro, në emër të shëmtimit trupor shumën prej 1,000.00 Euro, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 12,000.00 Euro, për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë shumën prej 600.00 Euro, për ushqim të përforcuar shumën prej 900.00 Euro, për shërimin klimatik shumën 3,276.00 Euro, për shpenzimet e mjekimit shumën prej 3,501.62 Euro, për fitim të humbur e arritur për pagesë 7,451.00 Euro, shuma e përgjithshme për këto kategori të dëmit 37,728.62 Euro, ndërsa nga data 01.12.2019 për çdo muaj vijues dhe gjersa të ekzistojnë kushtet ligjore t'ia paguaj shumën prej 160.00 Euro, të gjitha me kamatë prej 8% nga dita e nxjerrjes së këtij Aktgjykimi e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 2,005.40 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të: Refuzohet si e pabazuar pjesa kërkesëpadisë së paditësit dhe atë për dhimbje fizike shumën prej 2,400.00 Euro, për frikë shumën prej 4,600.00 Euro, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 7,200.00€, për shëmtim shumën prej 1,000.00 Euro, për shpenzimet e mjekimit shumën prej 6,500.95 Euro si dhe pjesën e shpenzimet të procedurës në shumën prej 1,674.80 Euro.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësit në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e paditësit në tërësi si të bazuar dhe të gjykojë si në propozim të kësaj ankese duke ia njohur edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1.674 € për përfaqësime gjyqësore.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën me këtë aktgjykim dhe ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar ose ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sipas pretendimeve të paditurës ose ta prish aktgjykimin e atakuar dhe lëndën t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

Me përgjigje në ankesë i autorizuari i paditësit ka kërkuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës, të aprovohet në tërësi ankesa e palës paditëse ashtu që të ndryshohet aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë dhe të vendoset si në propozim të ankesës së palës paditëse.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është pjesërisht e themeltë. Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij, me datë 29.05.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, kundër të paditurës, të precizuar si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 18.02.2020, me të cilën ka kërkuar që të: Detyrohet e paditura që paditësit t'ia shpërblej dëmin material dhe jomaterial nga lëndimet e pësuar në aksident trafikut të datës 18.04.2017 nga baza e autopërgjegjesisë duke ja paguar shumat e specifikuara si në petitum të precizimit të kërkesëpadsisë, por duke ja zbritur këtyre shumave, shumën prej 4.000 €, pasi që paditësi ka pranuar akontacion - paradhënie nga e paditura për shërim, me kamatën ligjore në shkallë prej 8 % duke filluar nga dita e paraqitjes së padsisë e deri tek pagesa definitive, gjithashtu ka kërkuar që tu njihen edhe shpenzimet e procedurës kontestimore sipas dispozitave të nenit 449, 452 paragraf 1, 2 dhe 3 të LPK-së, duke e detyruar palën e paditur që paditësit t'ia paguaj dhe të cilat i kanë specifikuar si në petitum të kërkesëpadsisë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padsisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.437/17, të datës 18.02.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga provat s nxjerra ka vërtetuar se me datë 18.04.2017, ka ndodhur aksidenti me fatalitet, ku paditësi ka qenë në cilësinë e pasagjerit. Deri te ky aksident ka ardhur me fajin e vozitësit tashmë të ndjerë Sh.H., i cili duke e drejtuar automjetin (të pasiguruar), në rrugën magjistrale Ferizaj-Prishtinë dhe me të arritur përballë firmës “.....” për një moment humb kontrollin mbi automjetin e tij dhe prej shiritit të vet të lëvizjes kalon në anën e majtë - jashtë rrugës kryesore, hyn në parkingun e auto sallonit “Ferizaj”, ku me këndin e majtë të përparmë e godet veturën e markës “....”, pastaj fillon të godas automjetin e markës “....” dhe nga shpejtësia e madhe përsëri nuk mund të ndalet dhe pas goditjeve të lartcekura, në fund godet pronën e paluajtshme këndin e depos “....”. Nga ky aksident paditësi ka thyer 7 brinjë, ka pasur gjakderdhje të brendshme, thyerje të shumëfishtë të krahut të djathtë. Si rezultat i këtyre lëndimeve paditësi ka pësuar dhimbje fizike dhe frikë, shëmtim trupor, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, ka pësuar fitim të munguar, gjithashtu ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë dhe ka pasur nevojë për rehabilitim klimaterik ushqim të përforcuar si dhe shpenzime gjatë shërimit, ndërsa përgjegjëse për mbulimin e dëmeve të tilla është e paditura, fakte të cilat sipas neni 173 dhe 183 të LMD-së, paraqesin bazë për kompensimin e dëmit.

Për lartësinë e kërkesëpadsisë sa i përket dëmit material dhe jomaterial, gjykata e shkallës së parë, ka marr për bazë mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. Sabit Sllamniku ortoped - traumatolog, Dr. Fatos Kelmendi neurokirurg dhe Dr. Samire Braina psikiatër, të cilët në mendimin e tyre profesional të dhënë në parashtrësën e datës 15.05.2019, kanë konstatuar se: paditësi, si pasojë e këtij aksidenti, ka pësuar këto lëndime trupore: st post fractura multifragmentaria scapulae i dex, contractura art H/S i Dex osteoarthristis art. H/S i dex et art acromioclavicularis dex paresthesia extremitatis superior i dex. Tendinitis m supraspinatus et caput longum m biceps brachi i dex, bursitis subacromioclavicularis i dex st post fractura serica costae I, II, III, IV, V, VI, VII, I dex pneumothorax traumatica i dex, të cilat lëndime kualifikohen si lëndime të renda trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve të pësuar, paditësi ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 2 orë, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në

kohëzgjatje prej 5 ditë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 2 muaj, dhe dhimbje fizike të intensitetit të ulët të cilat kanë vazhduar edhe sot e kësaj dite. Si pasojë e këtij aksidenti, paditësi ka përjetuar frikë dhe atë: frikë primare e cila ka zgjatur disa minuta, frikë sekondare e intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 48 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm e manifestuar në kohëzgjatje prej 3-6 muaj dhe frikë sekondare e intensitetit të ulët e cila vazhdon të jetë prezent edhe sot e kësaj dite. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 30.54 %. Shëmtimi trupor i shkallës së lehtë si pasojë e vragës torakostomisë në anën djathtë të toraksit në formë të rrumbullaket. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 3 muaj. Ndiqja dhe kujdesi nga personi i tretë ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 2 muaj. Rehabilitimi klimatik ka qenë i nevojshëm 3 herë nga 3 javë brenda dy viteve të para pas aksidentit.

Sipas ekspertizës së ekspertit të punës Dr. Ali Hajra e datës 25.06.2019, është konstatuar se paditësi për 6 mujorin e parë ka pasur paafatësinë e përkohshme dhe të plotë për çdo lloj pune fizike në shkallë prej 100 %. Nga data 18.10.2017, e tutje paaftësia e përhershme punuese të paditësi për punët të cilat i ka punuar deri në ditën e aksidentit të përshkruar si më lartë në shkallë prej 50 %, duke u përfshirë pengesat në dorën e djathtë siç është ngritja e dorës, rrotullimi i jashtëm dhe i brendshëm i dorës së nyjës së supit të djathtë, ngritja e peshës së rëndë me të njëjtën dorë si dhe mpirja dhe dhimbja e shpeshtë që ndikojnë në moskryerjen e punëve të cilat pengojnë kryerjen e punëve të cilat i ka punuar para aksidentit. Sipas ekspertizës së ekspertit të aktuaristikës së datës 25.11.2019 të ekspertit Aziz Berisha dhe plotësimit të saj të datës 24.01.2020 është konstatuar se paditësit i takon e drejta në fitimin e humbur - rentën e cila për periudhën e kaluar prej aksidentit të datës 18.04.2017 e deri më tani 30.11.2019, arrin vlerën prej në shumën prej 7.451 €, së bashku me kamatën e llogaritur me normë vjetore 8 % prej ditës së ushtrimit të padisë e deri me tani 30.11.2019 në shumën prej 848€ arrin gjithsej 8,299 €, për periudhën e ardhshme prej 01.12.2019 e tutje në shumën mujore prej 160 €, e cila nëse paguhet në formë menjëhershme - të kapitalizuar, arrin vlerën prej 30,835.20 €.

Gjykata e refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses dhe atë për dhimbje fizike shumë prej 2,400.00 Euro, për frikë shumë prej 4,600.00 Euro, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 7,200.00, për shëmtim trupor shumë prej 1,000.00 Euro, për shpenzime të mjekimit shumë prej 6,500.95 Euro si dhe pjesën e shpenzimeve të procedurës në shumë prej 1,674.80 Euro, pasi që shumat e kërkuara në padi dhe precizimin e saj ishin të larta e të cilat nuk përkojnë me asnjë praktikë gjyqësore dhe nuk janë në harmoni me lëndimin të paditësit duke marrë parasysh dhimbjet e përjetuara si dhe pasojat tjera të aksidentit, e tërë kjo duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertëve të mjekësisë si dhe krahasimin e praktikave gjyqësore lidhur me lëndimet dhe pasojat e ngjashme të këtij karakteri. Prandaj duke u bazuar në nenin.323 të LPK-së, në vlerësimin e lirë ka ardhur në përfundim se shumat e gjykuara në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, janë shuma reale dhe në përpjesëtim me dëmin e pësuar nga paditësi në këtë aksident. Ka shtuar se kompensimi i dëmit jomaterial, për shkak të natyrës subjektive dhe të brendshme të tyre, nuk mund të llogaritet mbi tabela dhe skema të parallogaritura vetëm për këtë qëllim. Prandaj, Gjykata e cakton atë duke u mbështetur në parimin e dhënies me drejtësi dhe ndershmëri sipas bindjes së saj të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre, po ashtu edhe duke marrë për bazë zhvillimin ekonomik-social të vendit tonë. Pra, gjykata ka vlerësuar se shumat e aprovuara janë në harmoni me qëllimin e shpërblimit të dëmit dhe është një satisfakcion i drejtë për paditësin. Sa i përket dëmit material paditësi përpos shpenzimeve të aprovuara, për pjesën tjetër të refuzuar nuk ka dëshmuar me prova materiale se të njëjtat vërtetë janë shkaktuar gjatë shërimit të tij.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar neneve 136, 137, 169, 173 dhe 179 të LMD-së, nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neneve 22, 24, 31 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

neneve 3, 4, 7, 9, 17 dhe 19 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, lidhur me nenet 143 dhe 323 të LPK-së. Për kamatën gjykata ju ka referuar nenit 382 të LMD-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të ndërgjyqësve se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjeshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat, përkatësisht faktet e çështjes mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë nga cila rrjedh se në bazë të provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar fakti se aksidenti i komunikacionit rrugor ka ndodhur me datë....., rreth orës minuta, në rrugën magjistrale Prishtinë - Ferizaj, përkatësisht me të arritur përballë firmës "...", Komuna e Ferizajt. Automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë i pa siguruar, Shkaktari kryesor i cili ka përgjegjësi ekskluzive dhe të vetme në shkaktimin e këtij aksidenti, është drejtuesi i automjetit i tipit "....." me targa, ngjyrë e, të cilin në momentin e aksidentit e drejtonte Sh.H. nga Ferizaj. Padiësi, në cilësinë e bashkudhëtarit nuk ka kontribuar në shkaktimin e këtij aksidenti por si pasojë e këtij aksidenti, pëson lëndime të rënda trupore. Të gjitha këto rrethana nuk janë kontestuar nga palët. E paditura gjatë shqyrtimit kryesor në shkallë të parë nuk e ka kundërshtuar faktin se padiësi ka pësuar lëndime të rënda trupore, nuk ka kontestuar se padiësi ka përjetuar dhembje fizike, frikë, dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimit trupor, si pasojë e këtij aksidenti, siç kanë deklaruar ekspertët mjekësor në mendimin e tyre profesional. Pra, e paditura i ka pohuar pothuajse të gjitha faktet e theksuara më lartë, duke i ofruar padiësit në formë të paradhënies shumë prej 4.000 €, për të gjitha format e dëmit material dhe jomaterial. Në këtë rast e paditura edhe pse e ka kundërshtuar bazën juridike dhe lartësinë e kërkesëpadisë gjatë shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë, e njëjta me asnjë provë bindëse nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimeve nga padia edhe pse ka pasur për detyrë ta bëjë një gjë të tillë, në kuptim të nenit 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin padiësit gjen mbështetje në dispozitat e nenit 18 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia; lidhur me nenin 173, 179 dhe 183 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore nga të dyja palët, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me kërkesëpadinë sa i përket dëmit jomaterial për padiësin A.B. dhe atë: për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimin trupor, Gjykata e Apelit vlerësoj se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë për këto kategori të dëmit në atë mënyrë që shumica e gjykuar është në ekuivalencë më të mirën e shkelur/cenuar, duke siguruar që

kompensimi të shërbej si satisfakcion për paditësin. Gjykata drejtë ka vlerësuar dhe vendosur sa i përket këtyre kategorive të dëmit jomaterial sepse vlerësimi i gjykatës është në harmoni edhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor të cilët kanë konstatuar se paditësi ka përjetuar dhimbje fizike dhe frikë të konstatuara si më lartë, po ashtu kanë konstatuar se paditësi ka shkallë të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 30.54 % dhe shëmtim trupor - shkalla e ulët e shëmtimit, e rrjedhimisht edhe me rrethanat tjera të cilat i ka marrë në konsideratë gjykata, e të cilat ndikojnë në përcaktimin e lartësisë, siç është në këtë rast natyra dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi, llojin, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shkallën e shëmtimit trupor si dhe rrethanat tjera si moshën e paditësit dhe praktiken e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plot me nenin 183 të LMD-së, vendosi si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit A.B. është e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadiës rreth kompensimit të dëmit material dhe atë: për zvogëlimin e aftësisë punuese - fitimin e humbur, ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar, për arsye se me nenin 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur më këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”, në këtë rast paditësit i takon e drejta në kompensimin e këtyre llojeve të dëmit material, për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe për ushqimin e përforcuar përkundër faktit se paditësi për këto kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale, kjo gjykatë vlerëson se duke u nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave në Kosovë, në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloji dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, gjykata ka konstatuar se në këtë rast paditësi ka pasur nevojë për ndihmë dhe përkujdesje të huaj prej 2 muaj dhe ushqimi të përforcuar prej 3 muaj, të njëjtit i takon ky lloji kompensimi i kërkuar në shumat e gjykuara, pasi që edhe më vetë kriteret e caktuara nga Kompanitë e Sigurimeve në Kosovë, të cilat nuk janë obliguese për gjykatat me rastin e vendosjes, por mund të merren si kritere orientuese, rezulton se të njëjtat në rastet e aksidenteve të komunikacioneve, të dëmtuarve ju njohin të drejtën në kompensimin e dëmit për kujdes nga personi i tretë dhe ushqim të përforcuar. Ndërsa në këtë rast lartësia e kërkesës për këto kategori të dëmit është reale në raport me kohëzgjatjen për nevojën për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqim të përforcuar, duke vendosur si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit A.B. është e bazuar, lidhur me pjesën e kërkesëpadiës për kompensimin e dëmit material për zvogëlimin e aktivitetit punues - fitimin e humbur për periudhën e kaluar nga data 18.04.2017 - 30.11.2019 dhe prej datës 01.12.2019 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, së bashku me kamatën, për arsye se me nenin 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera te nevojshme lidhur më këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit ” si dhe lidhur me nenin 172 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar”, ndërsa me paragrafin 2, të po këtij neni, përcaktohet se: “ Renta në të holla e gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit

paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diç tjetër”. Në këtë rast gjykata duke iu referuar kërkesës së paditësit ka lejuar që më anë të ekspertizës financiare - të aktuaristikës të datës 25.11.2019 dhe plotësimit të saj të datës 24.01.2020 të bëhet llogaritja e fitimit të humbur dhe nga kjo ekspertizë gjykata ka konstatuar se fitimi i humbur për periudhën kohore nga data 18.04.2017 - 30.11.2019, është në shumën prej 7.451 €, ndërsa kamata është llogaritur me normë 8 % vjetore e sipas arritjeve mujore të rentave për pagesë prej ditës së ushtrimit të padisë e deri me tani 30.11.2019 është 848 € arrijnë gjithsej 8.299 €, ndërsa në emër të fitimit të humbur prej datës 01.12.2019, e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore në shumën mujore prej 160 €, e cila paguhet në formë të menjëhershme - të kapitalizuar, ku arrin vlerën prej 30,835.20€. Pra, shuma e gjithmbarshme e rentës për periudhën e kaluar së bashku me kamatë dhe për periudhën e ardhshme të paguar në formë të menjëhershme të kapitalizuar arrin vlerën prej 7.451, kamata 848+30.835.20 €ë39,134.20 €. Në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, sa i përket kamatës për fitimin e humbur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjykata e Apelit e ka pranuar fitimin e humbur për paditësin duke pas parasysh ekspertizën e cila vlerësimin e ka mbështetur në rrethanën objektive për t'a nxjerrë lartësinë dhe atë në shkallën e zvogëlimit të aktivitetit punues dhe duke marrë për bazë kontributin e paditësit si pronar i biznesit individual N.T.P “.... . Edhe Gjykata e Apelit e pranon si të besueshme, profesionale dhe të argumentuar mirë ekspertizën e aktuaristikës dhe plotësimin e saj.

Lidhur me pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, me të cilën është refuzuar kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e dëmit jomaterial mbi shumat e gjykuara dhe për shpenzimet e procedurës, Gjykata e Apelit vendosi si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për shkak se në këtë rast shumat e kërkuara nga paditësi kanë qenë të larta dhe se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të shërbente qëllimit të kompensimit të dëmit.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar sa i përket kompensimit të dëmit material për shpenzimet e mjekimit, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të nenit 195 paragrafi 1 pika e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit përkitazi me dëmin material, për shpenzimet e mjekimit, Gjykata e Apelit, vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme sepse kjo mënyrë e vendosjes gjen mbështetje në nenin 179 paragrafi 1 të LMD-së. Në këtë rast palës paditëse si pasojë e aksidentit ju kanë shkaktuar shpenzime të mjekimit dhe shpenzime tjera lidhur me këtë gjë e cila është vërtetuar me provat - kuponët fiskal, faturat dhe dëftesë pagesat prezent në shkresat e lëndës të cilat janë administruara nga gjykata e shkallës së parë, por për llogaritja e shpenzimeve është bërë në mënyrë të gabuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, për çka gjykata vendosi në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi sa i përket kamatës është në pajtim me të drejtën materiale. Lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 18.02.2020, e deri në pagesën definitive, sepse paditësi për dëmin dhe lartësinë e tij, ka ra në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e tij për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Pika I, e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën e kërkesëpadisë sa i përket kompensimit të dëmit material për rehabilitimin klimaterik nuk është shqyrtuar, sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi me pjesën sa i përket kompensimit të dëmit material për rehabilitimin klimaterik.

Nga arsyet e paraqitura me lartë e në pajtim me nenin 194, 195 paragraf 1 pika d) dhe e) lidhur me nenin 200 dhe 201 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3809/20, me datë 13.03.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli